

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **DOGANA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:201/13300-26-3032-5-2-1

Sa i përket tenderit për "Ndërtimi i objektit për vendosjen e skanerit për kontrollin e mallrave doganore në Pikën e Kalimit Kufitar (PKK) Jarinjë"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ALCO CONSTRUCTION SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Gjilanit, nr. 81, Partesh

(Adresa)

Partesh

60000

(Vendi)

(Kodi postar)

045/240-008

/

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Alban Hyseni

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alcorg.info

(Adresa elektronike)

25.08.2026

(Data e parashtrimt të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Përmbledhje e aktivitetit

- Autoriteti Kontraktues (AK): Dogana e Kosovës
- Publikimi i Njoftimit për Kontratë dhe Dosja e Tenderit: 07.05.2026.
- Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve dhe hapja publike: 01.06.2026, ora 14:00.
- Proces verbali i hapjes së Tenderëve 01.06.2026
- NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES - 19.06.2026
- Lloji i procedurës: procedurë e hapur; kontratë publike kornizë për punë, me çmime për njësi. Vlera e parashikuar: 150,364.53 EUR.
- Kriteri i dhënies së kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.
- Oferta jonë: 119,959.91 EUR; Oferta e OE të rekomanduar, ENGINEERING RK SH.P.K.: 141,111.11 EUR; Diferenca: 21,151.20 EURO
- Kërkesë për rishqyrtim - 24.06.2026
- Vendim për pezullimin e aktivitetit 24.06.2026
- Vendimi për rishqyrtimin e kërkesës - 01.07.2026
- Anulimi i B58-NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK-së 01.07.26
- Pas vendimit të parë dhe procedurës paraprake të rishqyrtimit, aktiviteti është kthyer në rivlerësim
- Njoftimi mbi vendimin e AK - B58 i kontestuar është publikuar më 05.08.2026, me të cilin jemi eliminuar dhe kontrata i është rekomanduar OE ENGINEERING RK SH.P.K.
- Ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim më 10.08.2026.
- AK e ka refuzuar kërkesën me vendimin e datës 17.08.2026. Vendimi është pranuar në platformën e-prokurimit më 17.08.2026, në orën 15:56.
- Ankesa është brenda afatit dhjetëditor sipas nenit 109 të LPP-së dhe nenit 64.1 të Rregullores për Prokurimin Publik.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar më 10.08.2026.

Ne e kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim më 10.08.2026 kundër Njoftimit B58 – Njoftimi mbi vendimin e të datës 05.08.2026.

AK ka njoftuar për zgjatjen e afatit të vendimit më 12.08.2026 dhe ka nxjerrë vendim refuzues më 17.08.2026. Vendimin e kemi pranuar në platformën e-prokurimit më 17.08.2026, ora 15:56.

Kopjet e kërkesës dhe vendimit ia bashkëngjitem kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi dhe Përdorimi i drejtë i fondeve publike;
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7, veçanërisht paragrafët 1, 2 dhe 6, i LPP-së – Trajtimi i barabartë, Jo-

diskriminimi, Transparenca;

- **Neni 27 i LPP-së** – Detyrueshmëria e kërkesave të Dosjes së Tenderit;
- **Neni 56.3 i LPP-së** – Ndalimi i përjashtimit mbi bazën e një kërkesë ose kriteri të pacaktuar në njoftim/dosje;
- **Neni 59.2 dhe 59.4 i LPP-së** – Sqarimi i tenderit dhe trajtimi i gabimeve, paqartësive ose devijimeve të vogla;
- **Neni 69 i LPP-së** – Dëshmitë e aftësisë teknike dhe profesionale;
- **Neni 72, paragrafët 1–3, i LPP-së** – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë;
- **Neni 108/A, paragrafi 12, i LPP-së** – Detyrimi për arsyetim të vendimit në procedurën paraprake;
- **Neni 38.1–38.8 i Rregullores për Prokurimin Publik** – Sqarimi i tenderëve, Kushtet e barabarta dhe Vendimmarrja pas shqyrtimit të përgjigjeve;
- **Neni 45.20–45.24 i Rregullores** – Rëndësia e formulimit të Dosjes së Tenderit, Sqarimi i paqartësive dhe ndalimi i përdorimit të kriterëve të paspecifikuara;
- **Nenet 62.2 dhe 63 të Rregullores** – Vendimi i arsyetuar dhe Trajtimi i kërkesës për rishqyrtim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Objekti i ankesës dhe Interesi ynë juridik

Ne, "ALCO CONSTRUCTION" SH.P.K., në cilësi të palës së interesuar lidhur me aktivitetin e prokurimit, e parashtrojmë këtë ankesë kundër Vendimit të AK-së të datës 17.08.2026 dhe Njoftimit B58 të datës 05.08.2026. Jemi palë e interesuar sepse kemi dorëzuar ofertën prej 119,959.91 €, e cila ishte oferta me çmimin më të ulët dhe po të vlerësohej ligjërisht si e përgjegjshme, do të kishim mundësi reale për t'u shpallur fitues dhe të rekomandoheshim për dhënien e kontratës. Vendimin e datës 17.08.2026 e kemi pranuar në orën 15:56 të së njëjtës dite; këtë ankesë e dorëzojmë brenda afatit të nenit 109 të LPP-së.

II. Vlerësimi fillestar dhe shpallja jonë si tenderues i suksesshëm

Me Njoftimin B58 të datës 19.06.2026, pas vlerësimit fillestar të ofertave, AK-ja na ka shpallur tenderues të suksesshëm dhe ka rekomanduar Dhënien e Kontratës për ALCO CONSTRUCTION SH.P.K., me çmimin prej 119,959.91 €. Në letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm, AK-ja ka deklaruar se oferta jonë ishte vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit dhe se ne kishim paraqitur tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ky vendim ishte i përkohshëm dhe se AK-ja kishte rivlerësuar ofertën pas kërkesës për rishqyrtim. Ndryshimi i rezultatit nga shpallja jonë si tenderues i suksesshëm në eliminimin tonë duhej të mbështetej në prova të verifikuara dhe në një arsyetim të plotë. AK-ja është mbështetur kryesisht në deklaratën e mëvonshme të gjeodetit, pa i shqyrtuar në mënyrë të barabartë provat kundërtënëse dhe pa na kërkuar sqarime formale sipas nenit 72 të LPP-së.

Ky vendim vërteton se AK-ja fillimisht e kishte vlerësuar ofertën tonë si të përgjegjshme. Por, ndryshimi i mëvonshëm i rezultatit pa verifikim të plotë dhe pa arsyetim bindës cenon transparencën, trajtimin e barabartë dhe sigurinë juridike të procedurës.

III. Faktet vendimtare të pranuar nga vetë AK-ja

Letra e eliminimit e 05.08.2026 përmend gjeodetin, licencën e inxhinieres së elektroteknikës dhe listën e punëtorëve.

Në vendimin e 17.08.2026, AK e quan deklaratën e gjeodetit "arsyeja kryesore" e eliminimit.

Në të njëjtin vendim AK pranon se inxhinierja Eglantina Demiraj posedon licencën profesionale E.1284/2, të lëshuar nga ministria përkatëse e Republikës së Shqipërisë

AK pranon gjithashtu se lista jonë e punëtorëve e plotëson numrin e kërkuar nga FDT, ndonëse dokumenti kishte titull/numër të një projekti tjetër.

Në FDT 9.1 të Dosjes së Tenderit - **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - (pika d)** kërkohet një inxhinier i gjeodezisë, së paku një vit përvojë pas diplomimit dhe së paku një projekt në fushën përkatëse; FDT 9.2 - kërkohet diploma, licenca, kontrata/marrëveshja valide për këtë projekt dhe referencë ose dokument tjetër për përvojën.

AK pranon se ka marrë më 03.07.2026 komunikime dhe autorizim lidhur me gjeodetin, por i ka përjashtuar nga vlerësimi sepse kanë ardhur nga një palë që AK nuk e ka konsideruar pjesë të ofertës; AK nuk na ka kërkuar sqarim formal në platformë dhe nuk i ka kërkuar vetë gjeodetit sqarim të drejtpërdrejtë mbi autorizimin dhe marrëdhëniet e pretenduara.

Autorizimi i nënshkruar dhe vulosur nga Izjadin Sylja mban datën 05.02.2024. Ai autorizon Valbon Sherifin që, në emër dhe për llogari të tij, të përdorë diplomën, licencën, CV-në, referencat dhe dokumentacionin profesional në tenderë publikë/privatë, shprehimisht edhe kur KUOTA SH.P.K. nuk është pjesë e konsorciumit. Autorizimi deklarohet i vlefshëm deri në revokim me shkrim.

Akti noterial LRP nr. 7991/2022, i datës 26.05.2022, e identifikon Valbon Sherifin si të autorizuar të KUOTA SH.P.K. dhe provon kapacitetin e tij për përfaqësim dhe administrim dokumentacioni.

Në emailin e datës 03.07.2026, Valbon Sherifi deklaron se dokumentacionin e gjeodetit na e kishte dorëzuar vetëm neve, ALCO CONSTRUCTION SH.P.K., më 18.05.2026 dhe se për këtë tender kishte komunikuar/bashkëpunuar vetëm me ne. Data 18.05.2026 i paraprin afatit të dorëzimit të tenderëve, 01.06.2026.

Në rikonfirmimin e datës 03.07.2026, Izjadin Sylja mohon marrëveshjen me ne dhe autenticitetin/autorizimin e tri referencave. Megjithatë, ai pranon bashkëpunimin me KUOTA SH.P.K.; kjo deklaratë bie në kundërtënie me autorizimin e tij të datës 05.02.2024, i cili parashikon përdorimin e dokumenteve edhe kur KUOTA nuk është në konsorcium dhe mbetet në fuqi deri në revokim me shkrim.

AK i ka paraqitur OSHP-së edhe kërkesë për diskualifikimin tonë sipas nenit 99 të LPP-së, duke u mbështetur në të njëjtat deklaratë kundërtënie, pa paraqitur analizë që provon se të dhënat janë të rreme apo dokumenti është i falsifikuar dhe se paraqitja e tyre na atribuohet neve në kuptim të nenit 99.2 të LPP-së.

1. Moszbatimi i procedurës së sqarimit për kundërtënie lidhur me gjeodetin

AK është mbështetur në emailin e gjeodetit të datës 24.06.2026 dhe rikonfirmimin e datës 03.07.2026, sipas të cilave ai nuk kishte marrëveshje paraprake me kompanitë e përmendura dhe tri referencat nuk ishin autorizuar prej tij. Në anën tjetër, AK pranon se më 03.07.2026 ka pranuar komunikime dhe një autorizim që lidhet me të njëjtin gjeodet. Pra, Autoriteti Kontraktues ka pasur në dispozicion prova dhe deklarata që kundërshtojnë njëra-tjetrën për të njëjtën çështje, konkretisht për autorizimin e përdorimit të dokumenteve të gjeodetit Izjadin Sylja. Përballë këtyre provave kundërtënie, AK-ja kishte detyrimin të kërkonte sqarime formale dhe të verifikonte vlefshmërinë, fushëveprimin dhe revokimin eventual të autorizimit, para marrjes së vendimit për eliminim.

Autorizimi i datës 05.02.2024 nuk është dokument i krijuar pas afatit të tenderimit. Ai është nënshkruar dhe vulosur nga vetë Izjadin Sylja më shumë se dy vjet para kësaj procedure dhe i jep Valbon Sherifit mandat të gjerë për përdorimin e diplomës, licencës, CV-së, referencave dhe dokumentacionit profesional në procedura tenderimi. Formulimi i autorizimit mbulon shprehimisht edhe ofertimet ku KUOTA SH.P.K. nuk është fare në konsorcium dhe përcakton se vlefshmëria vazhdon deri në revokim me shkrim. Kësaj i shtohet emaili i 03.07.2026, në të cilin Valbon Sherifi deklaron se dokumentacionin ia kishte dorëzuar vetëm ALCO-s më 18.05.2026, para afatit të 01.06.2026. Akti noterial i 26.05.2022 provon gjithashtu statusin e Valbon Sherifit si person i autorizuar i KUOTA SH.P.K.

Pohimi i AK-së për përdorim pa autorizim nuk mund të pranohej pa verifikim dhe se ekzistenca e mandatit para afatit ishte objektivist e fiksuar. Këto prova tregojnë se, para afatit të dorëzimit të tenderëve, ekzistonte një autorizim i nënshkruar dhe i vulosur nga Izjadin Sylja, me të cilin Valbon Sherifi autorizohet të përdorte dhe administronte dokumentacionin e tij profesional në procedura tenderimi. AK duhej të verifikonte zinxhirin juridik Gjeodet-Valbon Sherifi-ALCO, marrëveshjen valide për projekt dhe autenticitetin e referencave, në vend që ta mbyllte çështjen vetëm mbi bazën e një deklarate kundërshtuese. Për këtë arsye, pretendimi i AK-së se dokumentet janë përdorur pa asnjë autorizim nuk mund të pranohej vetëm mbi bazën e deklaratës së mëvonshme të gjeodetit, pa e verifikuar më parë vlefshmërinë dhe fushëveprimin e autorizimit.

Personi i autorizuar, z. Valbon Sherifi, ia ka përcjellë Autoritetit Kontraktues, përmes funksionit "Forward All", të gjithë zinxhirin e komunikimit të zhvilluar me inxhinierin Izjadin Sylja, duke ia bashkëngjitur edhe autorizimin përkatës. Rrjedhimisht, AK-ja ka pasur në dispozicion jo vetëm deklaratën mohuese të mëvonshme të inxhinierit, por edhe komunikimet dhe autorizimin e mëhershëm, të cilat paraqisnin të dhëna me përmbajtje kundërtënie për të njëjtën çështje.

Përballë këtyre kundërtënieve, AK-ja nuk duhej të nixirte përfundim vetëm mbi bazën e deklaratës së inxhinierit, por duhej të kërkonte sqarime dhe dokumente shtesë nga ne, sipas nenit 72 të LPP-së. Nëpërmjet këtij sqarimi do të mund të verifikoheshin vlefshmëria dhe fushëveprimi i autorizimit, revokimi eventual i tij, mënyra e përcjelljes së dokumentacionit,

marrëveshja për projektin dhe autenticiteti i referencave. Mosrealizimi i këtij verifikimi ka ndikuar drejtpërdrejt në eliminimin tonë.

Njëkohësisht, rrethanat e krijuara ngrenë dyshime të arsyeshme lidhur me interesin dhe rolin e OE N.P.N. LIRIJA në iniciimin ose zhvillimin e kësaj çështjeje. Si rezultat i eliminimit tonë, si ofertuesi me çmimin më të ulët, dhe eliminimit të grupit në të cilin ka marrë pjesë N.P.N. LIRIJA, kontrata i është rekomanduar ofertuesit të radhitur pas tyre. Ky rezultat objektiv mund të ketë favorizuar në mënyrë indirekte ofertuesin e tretë.

Ne nuk e paraqesim këtë dyshim si fakt të provuar dhe nuk pretendojmë përgjegjësi pa administrimin e provave përkatëse. Megjithatë, konsiderojmë se kronologjia e veprimeve, komunikimet ndërmjet palëve dhe efekti përfundimtar mbi renditjen e ofertave duhet të shqyrtohen nga OSHP-ja. Në veçanti, duhet të verifikohet nëse ka ekzistuar ndonjë komunikim, bashkërendim ose interes i përbashkët ndërmjet operatorëve të përfshirë, si dhe nëse veprimet e ndërmarra kanë ndikuar në parimin e konkurrencës së drejtë, trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Në këto rrethana, çështja nuk mund të zgjidhet ligjërisht duke pranuar vetëm provën rënduese për ne dhe duke refuzuar provën sqaruese për shkak të burimit të saj. Neni 59.2 i LPP-së lejon sqarimin me shkrim të cilitdo aspekt të tenderit; neni 72.1–72.3 lejon plotësimin/sqarimin e informacionit dhe dokumenteve kur ekzistenca e tyre është e fiksuar para afatit të tenderimit; ndërsa neni 38.4 i Rregullores kërkon që AK të sigurojë kushte të njëjta dhe të kërkojë informacion për qartësimin e deklaratave ose certifikatave të paqarta, duke vendosur për vlefshmërinë vetëm pas shqyrtimit të përgjigjeve.

Sqarimi i kërkuar nuk do të duhej të lejonte krijimin e një marrëveshjeje, reference apo kapaciteti të ri pas 01.06.2026. Ai do të duhej të kufizohej në verifikimin objektiv nëse marrëveshja/autorizimi dhe përvoja e deklaruar kanë ekzistuar para afatit: datat origjinale, nënshkrimet, mandati i personit të autorizuar, zinxhiri juridik ndërmjet gjeodetit, personit të autorizuar dhe kompanisë sonë, si dhe autenticiteti i referencave. AK nuk e ka kryer këtë test. Në vendim nuk shpjegohet pse faktet nuk mund të verifikoheshin objektivisht ose pse një kërkesë e synuar për sqarim do ta ndryshonte materialisht ofertën.

Për më tepër, AK ka përdorur një deklaratë të një pale të tretë si provë vendimtare kundër nesh, por ka refuzuar komunikimet/autorizimin sqarues sepse vinin nga një palë e tretë. Ky standard asimetrik cenon nenin 7 të LPP-së. Mjeti proporcional dhe transparent ishte kërkesa formale B47 në platformë ndaj nesh dhe verifikimi i drejtpërdrejtë i dokumenteve me personat/institucionet përkatëse.

Për çështjen në fjalë, ju lutemi të kontaktoni z. Izjadin Syla, i cili është në dispozicion për të ofruar informacionin dhe sqarimet e nevojshme përmes telefonit ose e-mailit.

Telefoni: +38345/653-293; E-mail: izjadinsyla@gmail.com

2. Përdorimi i një kushti të paspecifikuar për licencën e inxhinieres së elektroteknikës

FDT 9.2(c) kërkon “licencë profesionale valide të lëshuar nga institucioni përkatës dhe oda përkatëse”; nuk përcakton që licenca duhet patjetër të jetë lëshuar nga një institucion i Republikës së Kosovës. AK në letrën e eliminimit ka përdorur mungesën e “licencës për veprimtari në Republikën e Kosovës” si vërejtje eliminuese, por në vendimin e 17.08.2026 pranon ekzistencën e licencës E.1284/2 të lëshuar nga ministria përkatëse e Shqipërisë.

AK nuk mund ta zgjerojë pas hapjes së ofertave një formulim të përgjithshëm të FDT-së duke shtuar një kërkesë territoriale të pashkruar. Kjo bie ndesh me nenin 7.6(v), nenin 56.3 të LPP-së dhe nenin 45.24 të Rregullores. Nëse AK kishte dyshim mbi ekuivalencën, fushëveprimin ose vlefshmërinë e licencës, duhej të kërkonte sqarim/verifikim, pa lejuar ndryshim material të ofertës. Vetë pranimi i licencës në vendimin refuzues e rrëzon formulimin fillestar se dokumenti “mungon”.

3. Lista e punëtorëve: gabim formal i pranuar si jo-material nga vetë AK-ja

AK pranon shprehimisht në vendimin e 17.08.2026 se lista e punëtorëve plotëson numrin e kërkuar, megjithëse titulli dhe numri i prokurimit i referohen një projekti tjetër. Kjo e bën të qartë se kapaciteti i kërkuar nuk mungon; kemi të bëjmë me titull të gabuar (gabim teknik) ose dokument shtesë të ngarkuar gabimisht.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, gabimet ose paqartësitë që korrigjohen pa ndryshuar kusht material, si dhe devijimet e vogla, nuk e bëjnë automatikisht ofertën të papërgjegjshme. Neni 45.21 i Rregullores parashikon që paqartësitë duhet të sqarohen sipas nenit 59.2. Pasi AK vetë e konfirmon përmbushjen numerike, kjo pikë nuk mund të qëndrojë si arsye eliminimi.

4. Vendimi i 17.08.2026 nuk përmban arsyetim të plotë dhe koherent

Vendimi përmbledh komunikimet, por nuk aplikon në mënyrë konkrete kriteret e nenit 72.3: nuk përcakton cilat dokumente kanë ekzistuar para 01.06.2026, cilat nuk kanë ekzistuar, cilat mund të verifikohen objektivisht dhe cili element do të përbënte ndryshim material. Formulimi se AK “nuk e ka vlerësuar si rast” për sqarim është përfundim, jo arsyetim juridik.

Vendimi është gjithashtu i brendshëm kontradiktor: dy vërejtje të letrës së eliminimit – licenca dhe lista e punëtorëve – pranohen faktikisht nga vetë AK-ja. Megjithatë, kërkesa refuzohet në tërësi pa përcaktuar efektin juridik të këtyre pranimeve. Kjo nuk përmbush standardin e nenit 108/A.12 të LPP-së dhe nenit 62.2 të Rregullores për një vendim të arsyetuar.

5. Cenimi i ekonomikitetit dhe i interesit tonë juridik

Oferta jonë është **119,959.91 €**, ndërsa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar është **141,111.11 €**, që paraqet një diferencë prej **21,151.20€**. Prandaj, nëse pas sqarimit dhe verifikimit objektiv konstatohet se oferta jonë i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit, ne duhet të renditemi në vendin e parë, sepse kriteri i dhënies së kontratës është "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët". Refuzimi i ofertës sonë pa përfunduar verifikimin jo vetëm që cenon interesin tonë juridik, por mund të rezultojë edhe në shpenzimin e **21,151.20 € më shumë të mjeteve publike**, në kundërshtim me parimin e ekonomikitetit dhe efikasitetit të përcaktuar në nenin 6 të LPP-së.

6. Kërkesa e AK-së për diskualifikimin tonë nuk provon kushtet e nenit 99 të LPP-së

Në kërkesën drejtuar OSHP-së, AK pohon paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar, por si bazë paraqet vetëm deklaratën e mëvonshme të gjeodetit dhe dokumentet e ofertës. AK nuk identifikon asnjë veprim konkret me të cilin ne kemi prodhuar, ndryshuar ose falsifikuar dokument, nuk provon lidhjen faktike e juridike midis nesh dhe falsifikimit të pretenduar dhe nuk e ballafaqon pohimin me autorizimin e datës 05.02.2024 dhe komunikimin e Valbon Sherifit.

Ne i kemi pranuar dokumentet më 18.05.2026 nga Valbon Sherifi, i cili paraqitet si person i autorizuar dhe dispononte autorizimin e nënshkruar e të vulosur nga vetë gjeodeti. Mungesa e kontaktit tonë të drejtpërdrejtë me gjeodetin nuk barazohet me falsifikim. Po ashtu, ekzistenca e një deklarate kundërshtuese pas hapjes së ofertave nuk provon vetvetiu se të dhënat janë të rreme, se dokumentet janë të falsifikuara ose se falsifikimi i pretenduar na atribuohet neve.

Tri referencat duhet të verifikohen drejtpërdrejt te subjektet që figurojnë si lëshuese, ndërsa autenticiteti, fushëveprimi dhe revokimi eventual i autorizimit duhet të verifikohen me dokumentet origjinale dhe me personat përkatës. Deri në përfundimin e këtij verifikimi, kërkesa për diskualifikim mbetet pretendim i paprovuar dhe nuk mund të përdoret si zëvendësim për vlerësimin objektiv të ofertës ose si paracaktim i përgjegjësisë sonë.

IV. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Në bazë të fakteve dhe dispozitave të mësipërme, ne i propozojmë Panelit Shqyrtues të nxjerrë këtë vendim:

APROVOHET si e bazuar ankesa e ALCO CONSTRUCTION SH.P.K.;

ANULOHET vendimi i Doganës së Kosovës i datës 17.08.2026 dhe Njoftimi B58 i datës 05.08.2026, në pjesën që lidhet me eliminimin tonë dhe rekomandimin për dhënie;

URDHËROHET AK që aktivitetin ta kthejë në rivlerësim dhe, përmes procedurës formale të sqarimit, të verifikojë vetëm faktet/dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para 01.06.2026, veçanërisht marrëveshjen/autorizimin, disponueshmërinë e gjeodetit dhe autenticitetin e referencave;

URDHËROHET AK të mos përdorë si arsye eliminimi mungesën e një licence kosovare që nuk është kërkuar shprehimisht në FDT dhe të trajtojë gabimin në titullin e listës së punëtorëve sipas pranimi të vet se numri i kërkuar është plotësuar;

URDHËROHET rivlerësimi në përputhje me FDT-në, LPP-në dhe parimin e trajtimit të barabartë; nëse pas verifikimit oferta jonë rezulton e përgjegjshme, të zbatohet kriteri "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët";

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e AK-së për diskualifikimin tonë sipas nenit 99 të LPP-së, përderisa nuk provohet me fakte konkrete paraqitja e të dhënave të rreme ose e një dokumenti të falsifikuar nga ana jonë;

KËRKOHET që OSHP-ja, para nxjerrjes së çdo përfundimi, t'i vlerësojë në mënyrë të barabartë të gjitha provat lidhur me autorizimin dhe referencat e gjeodetit, si dhe të marrë parasysh burimin dhe mënyrën se si dokumentacioni i është dorëzuar ALCO CONSTRUCTION SH.P.K.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Eliminimi ynë pa një vlerësim të plotë dhe të ligjshëm na ka mohuar mundësinë reale për t'u shpallur fitues të kontratës, ndonëse kemi paraqitur ofertën me çmimin më të ulët. Si rezultat, kemi pësuar shpenzime për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës dhe rrezikojmë humbjen e fitimit të pritshëm, angazhimit të stafit dhe mundësisë për të krijuar referencë profesionale nga realizimi i kësaj kontrate. Kërkesa jonë kryesore është anulimi i vendimit dhe kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim të ligjshëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05 Njoftim per Kontrat
2. B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 01.06.2026
3. B58- NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES - 19.06.2026
- 3.1 Kerkese nga AK - Per plotesimin e dokumentacionit sipas nenit 65 te LPP-se
4. Kërkesë për rishqyrtim - 24.06.2026
5. Vendim për pezullimin e aktivitetit 24.06.2026
6. Vendimi për rishqyrtimin e kërkeses - 01.07.2026
7. Anulimi i B58-NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK-së 01.07.26
8. Kërkesa per qasje ne dokumente
9. Kërkesë për zgjatje të vlefshmerisë 21.07.2026
10. B58- NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES --05.08.2026
11. Vendim mbi pezullimin i korrixhuar
12. 0.00 Kërkesa per Rishqyrtim Alco Construction
13. Kërkesë për rishqyrtim - Marisa 10.08.2026
14. Vendimi për rishqyrtimin e kërkeses -17.08.2026
15. Autorizimi i Izjadin Sylës për Valbon Sherifin, i datës 05.02.2024, me nënshkrim dhe vulë;
16. Akti noterial LRP nr. 79912022, datë 26.05.2022, mbi autorizimin nga KUOTA SH.P.K.
17. Kërkesë për diskualifikim të OE ALCo Contruction Sh.P.K.
18. Kundërrargumente dhe dëshmi ndaj kërkesës për diskualifikim
19. KORRESPONDENCA ELEKTRONIKE DHE DËSHMITË LIDHUR ME AUTORIZIMIN DHE PËRCJELLJEN E DOKUMENTACIONIT TË GJEODETIT IZJADIN SYLA
20. Email - Valbon Sherifi
21. Sqarime lidhur me Pretendimet për Diskualifikim
22. Dëshmia e pagesës së tarifës së ankesës

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*